



Pranimi / Dorezimi Priljeno / Predato Received / Delivery	13 - 04	2021	1	viti god year
Organ / Iniesta Organ / Jedinstvo Org / Unit	In Proc In Proc Proc No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRINSHOCK	1752/2021		1/3	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr. 109/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani – kryetar Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi, -anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi – Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar e ankesës A. Nr. 109/2021, të datës 26.02.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimin rruga „Dardania”, Apollonia 20 hyrja nr.4, nr. 15, nga Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Instituti i Kosovës për Administratë, Publike në çështjen juridike “Vlerësim i punës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.109/2021 e datës 26.02.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet** Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 29.01.2021 për ankuesin
- III. Detyrohet** Drejtoresha e Institutit të Kosovës për Administratën Publike, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, duke bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 26.02.2021, me numër protokollit 851/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin vjetor për vitin 2020, të vlerësuar nga Drejtoresha e Institutit të Kosovës për Administratë Publike, më arsyetim se vlerësimi vjetor, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 02.03.2021, me numër protokollit 920/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Instituti i Kosovës për Administrata Publike, ndërsa me datën 09.03.2021 me numër protokollit 1059/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.109/2021 e datës 26.02.2021, me numër protokollit 851/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Formuari i Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2020; vendimi i datës 07.03.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Plani i Trajnimit dhe Nëpunësit Civil; Inicimi i procedurës disiplinore; Vendimi i datës 19.01.2021, i Komisionit Disiplinor; kundërshtimi i datës 14.01.2021; Vendimi i datës 07.03.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje në ankesë e datës 09.03.2021, me numër protokollit 1059/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Bazuar në vlerësimin e rezultateve në vlerësim vjetor për ankuesin \_\_\_\_\_ Kolegji konstaton se ankuesi është vlerësuar nga Drejtoresha e Institutit të Kosovës për Administrata Publike, me notën e përgjithshme një pikë tetë (1.8).

Ankuesi, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, me datë 26.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës është bërë në kundërshtim me përshkrimin e detyrave të punës të përcaktuar për pozitën të cilën e mban ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar legjislacionin në fuqi, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se deri me datë 06.10.2020, kriteret dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil kanë qenë të përcaktuara me Rregulloren Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, ku sipas dispozitave të kësaj rregullore, vlerësimi i rezultateve të punës bazohet në matjen e realizimit të objektivave dhe aftësive të nëpunësit civil, sipas planit individual vjetor të punës dhe përshkrimit të detyrave të punës së tij.

Duke u bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin \_\_\_\_\_ në notën e përgjithshme një pikë tetë (1.8), të bërë nga Drejtoresha e Institutit të Kosovës për Administrata Publike, Kolegji për shqyrtim e ankesave ka konstatuar se Drejtoresha e Institutit të Kosovës për Administratën Publike, ka vepruar në kundërshtim, me nenin 11, paragrafi 2.4 . 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve publike, ku përcaktohet se; 2.4. **“kënaqshëm ose mjaftueshëm”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar vetëm disa nga objektivat e punës dhe ka treguar aftësi nën pritjet. Kontributi i tij nuk ka ndikuar, ose ka ndikuar vetëm pjesërisht në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit;**

Ndërlidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin \_\_\_\_\_ Kolegji për shqyrtim e ankesave ka konstatuar se ankuesi \_\_\_\_\_ e ka përgatitur planin e trajnimeve për vitin 2020, për tu realizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, dhe në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë, - rezultatet e zbatimit të objektivave del se Instituti i Kosovës për Administratën Publike, nuk ka realizuar trajnime ka pezulluar trajnimet, nga data 13.03.2020, deri me datën 03.07.2020. për arsye të gjendjes me Covid 19, në Kosovë, ndërsa për pjesën tjetër të vitit 2020, janë realizuar trajnimet në Institutin e Kosovës për Administratës Publike. prandaj kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi



ka realizuar objektiva e përcaktuar me përshkrim e detyrave të Punë dhe se vlerësim vjetor i ankuesit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se organi i punësimit Instituti i Kosovës për Administratë Publike, pas pranimit të vendimit të Këshillit, është i obliguar që të beje rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, duke marr parasysh të gjeturat si me lartë, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi për aprovimin e ankesës, anulimin e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2020 për ankuesin dhe kthimin e lëndës në rivlerësim të udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr. 109/2021



Rushit KAJTAZI  
Procesmbajtës

#### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtoreshës së Institutit të Kosovës për Administratë Publike;
- Udhëheqësit të Personelit në Institutin e Kosovës për Administratë Publike;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

